



UNIVERSITETI  
“ISMAIL QEMALI” VLORË



**NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM  
TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT  
INSTITUCIONAL**

**“RAPORTI I PYETËSORËVE TË  
CILËSISË SË MËSIMDHËNIES”**

**2022-2023**



**Punuan:**

**Rezarta Sinanaliaj**

**Romina Xhelaj**

**Harikla Beduli**

**RAPORT  
MBI REZULTATET E  
PYETËSORIT STUDENTOR  
MBI VLERËSIMIN E CILËSISË  
SË MËSIMDHËNIES PËR  
LËNDËT E ÇDO PROGRAMI  
STUDIMI PËR VITIN  
AKADEMIK 2022-2023**

**Përgatiti:**  
**Rezarta Sinanaliaj**  
**Romina Xhelaj**  
**Harikla Beduli**

**Miratoi: Prof.As. Enkelejd Mëhilli**

**Vlorë, Tetor 2023**

---



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

## Përmbajtja

1. HYRJE .....	2
2. BAZA LIGJORE .....	3
2.1. Ligji i Arsimit të Lartë .....	3
2.2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë .....	4
2.4. Vendime dhe Urdhëra të Brendshëm të UV-së .....	5
3. METODOLOGJIA .....	6
3.1 Metodologjia .....	6
3.2 Pjesëmarrja .....	7
3.3 Anonimati i studentit .....	8
4. KUFIZIMET E VLERËSIMIT .....	8
5. SHTOJCA .....	9
<i>Shtojca 1. Fakulteti i Ekonomisë</i> .....	9
<i>Shtojca 2. Fakulteti i Shëndetit</i> .....	9
<i>Shtojca 3. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore</i> .....	9
<i>Shtojca 4. Fakulteti i Shkencave Humane</i> .....	9



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

## 1. HYRJE

Në zbatim të Nenit 103 "*Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë*" të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr.80/2015 datë 22.7.2015, më specifikisht Pika 3 e tij ku citohet se: "*Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësinë studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi*" si dhe në kuadër të politikave të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për sigurimin e brendshëm të cilësisë me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të standarteve të cilësisë, të sanksionuara në Statut dhe dokumente të brendshme të institucionit, në fund të çdo viti akademik përpilohet raporti mbi rezultatet e pyetësorit studentor mbi vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.

Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies duke pasur në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit, studentët, ku këta të fundit vlerësojnë në mënyrë periodike programet e studimit dhe lëndët që ata ndjekin. Opinioni i tyre është një burim shumë i rëndësishëm informacioni për rritjen e cilësisë së shërbimeve akademike dhe programeve mësimore që ofron universiteti. UV-ja nëpërmjet këtij raporti ka për qëllim jo vetëm të masë dhe vlerësoj cilësinë e mësimdhënies duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, por gjithashtu të promovoj shembuj të praktikave të mira, duke nxitur dhe inkurajuar personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Të dhënat e pasqyruara në këtë raport do të jenë një instrument i rëndësishëm për Njësitë Kryesore/Bazë, bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore aty ku shihet e nevojshme.

Në Raport janë analizuar të dhënat e përfutuara prej anketimeve të kryera gjatë vitit akademik 2022-2023, për të dy ciklet e studimit, të organizuar në katër shtojcat të cilat përkojnë me organizimin e Njësive Kryesore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë:



✚ Fakulteti i Ekonomisë (*Shtojca 1*)

✚ Fakulteti i Shëndetit (*Shtojca 2*)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

-  Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore (*Shtojca 3*)
-  Fakulteti i Shkencave Humane (*Shtojca 4*)

Për secilën prej njësive kryesore paraqitja e rezultateve është konceptuar si pjesë që mund të qëndrojë e pavaruar për çdo program studimi. Për secilën prej pyetjeve të pyetësorit është pasqyruar grafikisht mesatarja aritmetike e përgjigjeve për programin e studimit (si mesatare aritmetike e përgjigjeve për secilën lëndë e shprehur në përqindje), njëkohësisht bashkëlidhur raportit gjenden përgjigjet e studentëve në përqindje për secilën prej lëndeve të programit të studimit.

Në vijim paraqitet procedura e ndjekur duke nisur prej implementimit dhe realizimit e pyetësorit si dhe hartimit të raportit të analizës së pyetësorit.

## 2. BAZA LIGJORE

### 2.1. Ligji I Arsimit të Lartë

Procesi i Anketimit të studentëve është një process i parashikuar në **Ligjin e Arsimit të Lartë Nr.80/2015 datë 22.7.2015, Kreu X, Neni 103** “Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë”, si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies ku thuhet shprehimisht:

1. *Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.*
2. *Njësia e Sigurimit të Cilësisë vlerëson, periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore- shkencore.*
3. *Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

4. *Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.*
5. *Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.*

## 2.2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë

Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, të përcaktuara në VKM Nr. 824, datë 24.12.2021, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë për institucionet e arsimit të lartë, programet e ciklit të parë të studimeve Bachelor, programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional", "Master i shkencave". Më specifiku në Standardet për Sigurimin e Cilësisë për Institucionet e Arsimit të Lartë :

**Standardi I.7** Institucioni harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë në programet e studimit që ofron.

**Standardi I.8** Institucioni monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vazhdueshme programet e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

**Standardi I.9** Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës.

**Standardi I.10** Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

Sandardi I.10 Institucioni përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Standardi I.11 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

2.3 Statuti i UV-së miratuar me Urdhër të MASR nr. 197, datë 01.04.2019, më specifikisht Neni 82: "NJSBCVI ka për funksion kryesor bashkëpunimin për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor si dhe zhvillimin cilësor të Uv-së si institucion i arsimit të lartë, mbështetur në standardet shtetërore të cilësisë, si dhe në standartet dhe udhëzimet europiane për Sigurimin e Cilësisë.

#### 2.4. Vendime dhe Urdhëra të Brendshëm të UV-së

- ❖ Vendim i Senati Nr. 97, datë 21.10.2020 "Miratimin e Pyetësorit për Vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies për Lëndët e çdo programi Studimi në UV".
- ❖ Vendim Senati nr. 21, datë 08.05.2018 "*Për procedurën e analizës dhe vlerësimin të pyetësorëve të studentëve për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë.*
- ❖ Detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin prej pozicionit të përcaktuara në shkresën Nr. 205/1 prot datë 14.02.2018 mbi "*Përshkrimin dhe detyrat e vendit të punës të personelit ndihmësakademik me karakter administrativ dhe personelit administrativ në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.* Njësia e Sigurimit të Cilësisë dhe Vlerësimin institucional:
  - ✓ Verifikon, mat dhe vlerëson, krahasuar me standartet e kërkuara realizimin e objektivave kryesorë të programeve të studimit dhe cilësinë e programeve të ofruara



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

- ✓ Realizon të gjitha detyrat që lidhen me vet-vlerësimin e programeve akademike në veçanti që kryhen çdo vit.

### **3. METODOLOGJIA**

#### **3.1 Metodologjia**

Metodologjia e studimit është sasiore dhe instrumenti i përdorur është pyetësori i miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr. 97 datë 21.10.2020. Pyetësori është i përbërë prej 14 (katërbëdhjetë) pyetjeve të mbyllura dhe 2 (dy) pyetjeve të hapura, nëpërmjet të cilave studentët kanë vlerësuar një sërë aspekte duke nisur prej strukturimit të leksioneve, përmbajtjes së leksioneve, transmetimit të dijeve prej pedagogut, nxitjes së dialogut, mendimit kritik në auditor etj. Përgjigjet për çdo pyetje janë gjeneruar prej platformës UVMS, të shprehura në përqindje. Vlen për t'u theksuar se për secilin rast është paraqitur njëkohësisht edhe marzhi i gabimit të përlogaritjes prej UVMS.

Pyetjet e mbyllura janë përpunuar statistikisht nëpërmjet platformës UVMS. Për secilën pyetje është pasqyruar grafikisht mesatarja aritmetike e përgjigjeve për programin e studimit (si mesatare aritmetike e përgjigjeve për secilën lëndë e shprehur në përqindje) si dhe tabela e hollësishme e përgjigjeve të studentëve për secilën lëndë në veçanti e cila gjendet bashkëlidhur në format excel.

Në pyetjet e hapura studentët kanë paraqitur opinionin e tyre mbi atë se çfarë kanë vlerësuar në lëndët përkatëse dhe çfarë do të sugjeronin për të përmirësuar. Marrë në konsideratë se përgjigjet e studentëve për këto pyetje janë specifike për secilën lëndë, u gjykua si e përshtatshme që të pasqyrohen sikurse janë shprehur studentët si dhe janë pjesë përbërëse e raportit përmbledhës të rezultateve të pyetësorit për secilën lëndë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

### 3.2 Pjesëmarrja

Në raport janë pjesëmarrës të gjithë studentët e Ciklit të Parë dhe Ciklit të Dytë të Studimeve pranë Universitetit "Ismail Qemali", që kanë një llogari personale në sistemin elektronik të Universitetit (UVMS). Sipas vendimit të Senatit Nr. 21 datë 08.05.2018, studenti plotëson pyetësonin vetëm për ato lëndë që është duke frekuentuar dhe që i ka rregjistruar në UVMS.

Institucioni me qëllim rritjen e përqindjen e studentëve pjesëmarrës në pyetëson për të nxjerrë rezultate sa më përfaqësuese prej këtij raporti ka ndërmarrë një masë shtrënguese duke mos lejuar që studentët të aksesojnë rezultatet e provimeve nëse nuk plotësojnë më parë pyetësonin për secilën lëndë që ata kanë frekuentuar gjatë një semestri të caktuar. Numri i pyetësorëve të plotësuar prej studentëve në programet e Ciklit të Parë të Studimeve për vitin akademik 2022-2023 është **11256 Pyetësorë**, si dhe numri i programeve të vlerësuara prej studentëve është **29 programe Bachelor si dhe 1 DIND**, të shpërndara nëpër fakultetet përkatëse.

Numri i pyetësorëve të plotësuar prej studentëve në programet e Ciklit të Dytë të Studimeve është **5726 Pyetësorë**, si dhe numri i programeve të vlerësuara prej studentëve është **31 programe MP dhe MS**, të shpërndara nëpër fakultetet përkatëse.

Së fundi numri i pyetësorëve të plotësuar prej studentëve të regjistruar në Programin e Studimit Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë në Drejtësi është **504 pyetësor**.

*Vlerat e larta të numrit të studentëve që shfaqen në tabelat për çdo fakultet nuk tregojnë numrin e përgjithshëm të studentëve që janë të rregjistruar në çdo programi studimi, por numrin e studentëve të rregjistruar në secilën lëndë të ofruar në vitin akademik 2022-2023 për atë program studimi. Një student ka të drejtë të regjistrohet nga 1 deri në 4 lëndë (40 kredite) për semestër dhe si rrjedhim ai plotëson pyetësonin për çdo njërin prej lëndëve që është duke frekuentuar.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

**Theksojmë se në raport janë paraqitur rezultatet e vlerësimit të studentëve për leksionet të cilat kanë frekuentuar gjatë vitit akademik, ndërkohë që rezultatet e vlerësimit të seminareve janë paraqitur sikurse janë gjeneruar në formë tabelare prej sistemit UVMS.**

### 3.3 Anonimati i studentit

Sistemi UVMS garanton anonimatit e studentëve të cilët kanë marrë pjesë në pyetësor pasi pranë NJSBCVI përcillen vetëm të dhënat e shprehura në përqindje për çdo pyetje të përpunuar për secilën lëndë. Përgjigjet e pyetësorit ruhen dhe përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga NJSBCVI dhe mbi bazën e tyre janë hartuar të dhëna statistikore për të evidentuar problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Në çdo rast, analiza e të dhënave të pyetësorit përcillet në fakultet në përfundim të vitit akademik 2022-2023, duke shmangur kështu çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

## **4. KUFIZIMET E VLERËSIMIT**

Gjatë procesit të realizimit të pyetësorit prej studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi, ashtu sikurse një vit më parë, për vitin akademik 2022-2023 vazhdon ende të mbetet kufizim:

- ❖ Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies së seminareve. Megjithëse studentët me pyetësorin e miratuar me VSA Nr. 97, datë 21.10.2020 kanë pasur mundësi të vlerësojnë seminarët e të gjitha lëndëve të cilat kanë ndjekur gjatë vitit akademik 2022-2023, përsëri nuk mund të identifikohet prej sistemit UVMS pedagogu përgjegjës i seminareve në rastet kur ndyshonte prej titullarit të lëndës. Duke qenë se studentët nuk mund të regjistrohen nëpërmjet sistemit UVMS në seminarët e lëndëve respektive. Për kapërcimin e kësaj sfide sugjerohet që studentët të regjistrohen nëpërmjet sistemit UVMS edhe në seminarët respektive. Vlen të theksohet se bashkëlidhur këtij raporti janë përcjellë edhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE PROJEKTEVE  
NJËSIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL

rezultatet e pyetësorëve për seminarët për çdo lëndë, nën seksionin e vlerësimit të leksioneve të titullarit të saj.

- ❖ Edhe për këtë vitin akademik 2022-2023 mbetet ende si një **kufizim kryesor** i këtij raporti përpunimi të dhënave dhe paraqitja grafike statistikore manualisht nëpërmjet stafit NJSBCVI dhe jo drejtpërdrejtë prej sistemit UVMS.

Realizimi I paraqitjes grafike të rezultateve nëpërmjetë sistemit UVMS do të shmangte jo vetëm marzhin e madh të gabimit që ka përpunimi i këtyre të dhënave **manualisht** prej specialistëve NJSBCVI, por gjithashtu dhe angazhimin e tyre për një kohë të gjatë (duke marrë në konsideratë që për çdo fakultet kërkohen 2 muaj punë) duke u krijuar vështirësi në ndjekjen e detyrave të tjera të planit të punës.

- ❖ Kërkesë për krijimin e një moduli për përpunimin në mënyrë kompjuterike të të dhënave dhe grafikët respektiv, kërkesë kjo e dërguar me shkresën **Nr 303 Prot**, datë **10.02.2023** mbi "Propozimin për krijimin e një moduli në UVMS për përpunimin grafik të rezultateve të pyetësorit të studentëve për cilësinë e mësimdhënies

## 5. SHTOJCA

- ✚ Shtojca 1. Fakulteti i Ekonomisë
- ✚ Shtojca 2. Fakulteti i Shëndetit
- ✚ Shtojca 3. Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore
- ✚ Shtojca 4. Fakulteti i Shkencave Humane